



PËR NJË TË ARDHME



TË NDRITUR

NE KONTRIBUOJMË PËR DEMOKRACINË

HARBIN (13), AGNESA (11), OLTA (10), DIELLZA (11), BUTRINT (11), ERMAL (11)



Të dashur qytetarë, nga ne do të mësoni se pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes

Demokrati do të thotë qeverisje e popullit, sepse vet fjala demokrati rrjedh nga dy fjalët greke „demos“ që i bie popull dhe „kratos“ që i bie qeverisje. Demokracia për herë të parë është shfaqur në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë nuk respektoheshin të gjitha elementet e demokracisë. Për shembull, nuk kishte barazi dhe as nuk respektohej shprehja e lirë e mendimit, sepse gratë nuk e kishin të drejtën e votës. Këtë të drejtë e kishin vetëm të pasurit dhe burrat. Kurse tash, i kemi të drejtat e barabarta si burrat ashtu dhe gratë. Barazia është vetëm një prej elementeve të demokracisë, sepse në demokrati bëjnë pjesë edhe shumë elemente të tjera të tilla si: toleranca, të drejtat e barabarta, mendimi i lirë, solidariteti, përgjegjësia, zgjedhjet, liria, drejtësia etj. Këto elemente duhet të zbatohen nga të gjithë ne, në mënyrë që të kemi demokrati

sa më të plotë. Dy llojet më të njohura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë edhe ajo përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemin parlamentar dhe presidencial. Tek sistemi parlamentar populli zgjedh deputetët, kurse tek sistemi presidencial populli e zgjedh Presidentin. Kosova ka demokrati përfaqësuese parlamentare, sepse populli zgjedh 120 deputetë, kurse deputetët e zgjedhin Presidentin. Ne jemi shumë të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik, siç është Kosova. Por, asnjëherë nuk duhet harruar që secili prej neve duhet të kontribuoj që ta fuqizojmë demokracinë. Këtë fuqizim mund ta arrijmë duke i zbatuar elementet e lart cekura të demokracisë. Së bashku mund të bëjmë më të mirën për shtetin tonë, sepse vetëm kështu mund të jetojmë të gjithë të lumtur dhe të barabartë. Mesazhi ynë për ju është: respektojeni sa më shumë demokracinë, sistemin më të mirë të qeverisjes.



Të gjithë jemi të barabartë



Gazetarët e demokracisë

QYTETARËT NË DEMOKRACI

LEONORA (12), ERA (12), RONA (11), HASAN (11), ERON (11)

Demokracia na ofron shumë të drejta, mirëpo edhe ne duhet të jemi qytetarë aktiv në demokraci

Ne jemi qytetarë të Republikës së Kosovës dhe sot kemi ardhur në „Demos-ti“, nga shkolla fillore „Zenel Hajdini“. Në Punëtorinë e Demokracisë ne kuptuam se çfarë do të thotë të jemi qytetarë aktiv. Qytetarë aktiv mund të jemi duke pastruar ambientin, duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke qenë të pranishëm në tubime publike etj. Pasi të mbushim 18 vjet ne do të jemi aktiv në të gjitha mënyrat që i përmendëm më lart. Megjithatë, edhe ne në moshën tonë jemi aktiv duke pastruar ambientin, duke mësuar, e në këtë mënyrë do të jemi të suksesshëm dhe do të ndihmojmë vendin tonë.

Ne u bëjmë thirrje lexuesve tanë që edhe ata të jenë aktiv sepse vetëm kështu mund të kemi të ardhme më të mirë.



Autorët e artikullit



Në lojë ne nuk njohim racë apo fe. Në shkollën tonë të gjithë jemi të barabartë dhe të lumtur luajmë së bashku




A e keni menduar ndonjëherë se demokracia na siguron të gjithë neve të drejtën e strehimit?



Qytetarët e mirë kujdesen për ambientin. Bëhuni të tillë



Ne kurrë nuk e kalojmë rrugën në dritën e kuqe të semaforit




Kuvendi, vendi ku nxirren ligjet për popullin



Kuvendi ka funksion ligjvënës



Votimi bën ndryshim, prandaj vota jote ka vlerë




Kuvendi i zbaton parimet e demokracisë



Kështu duket një vend-votim



Qytetarët i zgjedhin kandidatët më të mirë



Ne jemi qytetarë aktiv



Shprehja e lirë e mendimit është demokraci

KUVENDI, ZËRI I POPULLIT

LEART (11), UNTELA (11), ALBION (11), FATJONA (11), ERNIS (12)



Kuvendi i Republikës së Kosovës është vendi ku propozohen, miratohen dhe shfuqizohen ligjet

Në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë, të cilët na përfaqësojnë neve si qytetarë të Republikës së Kosovës. Ne gjithashtu e kemi një President, të cilin e zgjedhin deputetët tanë, e që mund edhe ta shkarkojnë nga detyra nëse ai apo ajo nuk e kryen punën si duhet. Presidenti ndër të tjerash punon në mënyrë që shtetet e tjera ta njohin Kosovën si vend të pavarur. Deputetët mbledhen një herë në javë dhe diskutojnë për çështje të rëndësishme, e ato mbledhje quhen seancat plenare, të cilat zakonisht mbahen ditëve të enjte. Prej 120 ulëseve që janë për deputetë, 20 prej tyre janë të rezervuara për komunitetet jo shumicë, siç janë: komuniteti serb, boshnjak, ashkali, romë, egjiptian dhe komuniteti turk.

Kuvendi ka disa funksione siç janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe funksioni i kontrollit. Quhet funksion legjislativ sepse deputetët kanë të drejtë t'i propozojnë ligjet dhe t'i miratojnë ato. Quhet funksion përfaqësues sepse ne jemi ata të cilët i zgjedhim deputetët, për këtë arsye ata na përfaqësojnë neve qytetarëve. Quhet funksion i kontrollit, sepse deputetët e zgjedhin Kryeministrin, ndërsa ai e udhëheq Qeverinë. Për atë arsye deputetët kërkojnë llogari nga Qeveria për mënyrën se si i kryejnë punët.

Në Kuvend kemi tri mënyra të votimit: votimi me dorë, votimi me letër si dhe ai elektronik.


Deputetët janë zëri i popullit, sepse ata marrin vendime në emrin tonë, prandaj ne themi se Kuvendi është „Shtëpia e Popullit“ ku merren vendime që e çojnë përpara Kosovën tonë.



Sekreti i suksesit është puna



Bashkimi bën fuqinë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zenel Hajdini“
Klasa: 6/5
Vendi: Prishtinë